

VENDIM
Nr. 785, datë 18.12.2024

**PËR MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË TERMOCENTRALIT DHE VEPRAVE
NDIHMËSE, I CILI NUK ËSHTË OBJEKT KONCESIONI, ME VENDNDODHJE
NË ROSKOVEC, QARKU FIER, NGA SHOQËRIA “*FIER THERMOELECTRIC*”,
SHA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 49, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e ndërtimit të termocentralit dhe veprave ndihmëse, i cili nuk është objekt koncesioni dhe nuk përfiton nga masat mbështetëse, me vendndodhje në Roskovec, qarku Fier, nga shoqëria “*Fier Thermoelectric*” sh.a., me elementet, si më poshtë vijon:

- a) emri i aplikuesit: shoqëria “*Fier Thermoelectric*” sh.a.;
- b) numri i identifikimit personal të zyrës së taksave NIPT/NUIS: M22211019U;
- c) tipi i centralit: termocentral;
- ç) kapaciteti i instaluar: 170 mw;
- d) afati i pritshëm i vënies në punë dhe pajisja me leje ndërtimi: koha për ndërtimin, pajisjen me lejen e ndërtimit dhe vënien në operim të impiantit fotovoltaiik do të jetë brenda 36 (tridhjetë e gjashtë) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- dh) vendndodhja e burimit gjenerues të energjisë: në Roskovec, qarku Fier;
- e) afati i operimit: 49 (dyzet e nëntë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi;
- ë) koordinatat e tokës, sipas aneksit 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi;
- f) Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore kanë të drejtë të ushtrojnë mbikëqyrje të përgjithshme, me afate 3-mujore gjatë realizimit, vënies në punë dhe operimit, me synim që të verifikojnë se ecuria e punimeve, cilësia, konformiteti dhe operimi janë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe dokumentacionin e projektit;
- g) shoqëria “*Fier Thermoelectric*” sh.a., ka detyrimin që:
 - i. të paraqesë periodikisht (çdo tre muaj) pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore informacion për ecurinë e ndërtimit të termocentralit;
 - ii. të respektojë kushtet e cituara në lejet, licencat dhe autorizimet paraprake mjedisore, lëshuar nga institucionet përgjegjëse kombëtare;
 - iii. të dorëzojë sigurimin e kontratës, në masën jo më pak se 5% të vlerës së investimit, përpara nënshkrimit të kontratës, ndërmjet shoqërisë “*Fier Thermoelectric*” sh.a., dhe ministrisë. Në këtë kontratë përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve për realizimin e këtij projekti, penalitetet, në rast mosrealizimi, si dhe çështje të tjera, që lidhen me zbatimin e saj;
 - iv. t’i japë falas, në formë *royalty*, ministrisë përgjegjëse për energjinë sasinë e energjisë elektrike, në masën 2 (dy) % të sasisë vjetore të prodhimit të energjisë elektrike ose konvertimin e saj në vlerë monetare. Në rast konvertimi në vlerë monetare, shuma duhet të derdhet tërësisht në buxhetin e shtetit;

v. të përmbushë kërkesën, sipas rastit, që një pjesë e prodhimit të burimit gjenerues të energjisë t’i shitet furnizuesit publik, sipas legjislacionit në fuqi.


2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe shoqëria “*Fier Thermoelectric*” sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKSI 1

Koordinatat KRGJSH		
PIKAT	X (E)	Y (N)
1	473859.173	4514528.518
2	474040.579	4514756.205
3	474236.79	4514570.101
4	474236.957	4514557.495



Koordinatat e zones sipas 3 projeksioneve hartografike						
	Gauss-Kruger		KRGJSH		UTM	
	E/X	N/Y	E/X	N/Y	E/X	N/Y
A	438955.129	4515438.371	473859.173	4514528.518	389468.753	4513501.504
B	4389739.146	4515664.009	474040.579	4514756.205	389652.695	4513727.05
C	4389933.252	4515475.652	474236.79	4514570.101	389846.722	4513538.77
D	4389933.275	4515463.043	474236.957	4514557.495	389846.745	4513526.167